



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS SPANJOLLE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Didaktikë e Gjuhës së Huaj 2

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore; (20 leksione / 20 seminare);
Viti / Semestri : Viti III, semestri II
Lloji i lëndës : Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Bachelor në Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Hispanik
Kodi i etikës : Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Ky kurs synon: Thellimin e njohurive të marra gjatë lëndës së didaktikë 1. Të zhvillojë aftësinë e të reflektuarit dhe të argumentuarit në fushën e mësimdhënies dhe mësimit në gjuhën spanjolle. Është një lëndë praktike ku studenti duhet të vërë në jetë njohuritë e përfituara gjatë lëndës së Didaktikës së gjuhëve të huaj 1, duke i ndërlidhur këto njohuri me përvojën e tyre si nxënës të gjuhës spanjolle. Është një lëndë e orientuar drejt zhvillimit të praktikave të mësimdhënies e të mësimit.

Objektivat specifike lëndore:

1. Të aftësohet studenti me njohjen e elementëve didaktike të një klase të spanjishtes si gjuhë e huaj,
2. Të njohë rolin e të gjithë elementeve që kontribuojnë në procesin e mësimdhënies dhe mësimit.
3. Të hartojë njësi didaktike që i drejtohen një niveli të caktuar dhe një qëllimi të caktuar didaktik: leksiku, gramatika, kultura, etj.